



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LEZHË

Nr.29/GJ
Nr. 603/12 prot

Lezhe, me 20.06.2025

VENDIM

“PËR SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND TË TRETË TË PASURISË SË PALUAJTSHME”

Une, Stela Gjergji, me detyre Përmbareuese Gjyqësore pranë Zyrës Përmbarimore Lezhë, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes përmbarimore Nr.29/GJ të vitit 2025 bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.166 dt.13.03.2019 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lezhë lënë në fuqi me vendimin nr.412 dt.17.06.2019 nga Gjykata e Apelit Shkodër.

KONSTATOVA:

Se në datë 29.07.2019 është depozituar kërkesa e palës kreditore, pranë Zyrës së Përmbarimit Lezhë së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit të Kon_Huasë nr. 300 rep dhe 172 kol, datë 01.06.2017 me pale;

Kreditor: Drane Përlleshi.

Debitor: Fran Gjon Bushpepa.

Objekt: 1-Kthim shume + interesa bankare, -Shpenzime proceduriale përmbarimore.

Në zbatim të nenit 527 të K.Pr.C. “Për Vënien e Sekuestros” dhe nenit 563 të K.Pr.C “Për verifikimin e të drejtës së pronësive të debitorit” dhe të konfirmimit me shkresën nr. 5346 prot, datë 14.10.2024 të ASHK-Lezhë për regjistrimin e vendimit nr. 15 datë 24.01.2023 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lezhë për ndarjen e pasurisë në emër të debitorit Fran Gjon Bushpepa për pasuritë si më poshtë:

- 1- 4/819+1-1 volum 25 fq 49 zk 8631 me sip 27.31m² i pasurisë Apartament në pronësi të Fran Bushpepa
- 2- 4/819+1-3 volum 25 fq 51 zk 8631 me sip 56.21m² i pasurisë Apartament në pronësi të Fran Bushpepa
- 3- 4/819+1-5 volum 25 fq 53 zk 8631 me sip 28.8m² i pasurisë Apartament në pronësi të Fran Bushpepa

Me kryerjen e veprimit sa më sipër, në vijim të procedurës ekzekutivo-përmbarimore, duke qenë se palet debitor-kreditor nuk kishin një marrëveshje për vlerën e sendeve mbi të cilat është vendosur sekuestroja, u përcaktua me ekspert të licensuar vlera e sendeve të sekuestruara duke u bazuar konkretisht në vlerën e lire të tregut të përcaktuar në raportin e vlerësimit të paraqitur nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme, kopje të të cilit u është komunikuar zyrtarisht të gjitha palëve të marrëdhënies juridike të sipërcituar, të cilat kanë marrë dijeni zyrtarisht.

Me shkresën nr. 29/GJ datë 12.02.2025 në bazë të nenit 567 të Kodit të Proçedurës Civile është lajmëruar debitori (Fran Bushpepa) se brenda 10 ditëve të njoftimit nuk do të përmbushë detyrimin, sendi i sekuestruar do të shitet në ankand. Sipas akteve të administruara në dosjen përmbarimore rezulton se detyrimi i mësipërm nuk është përmbushur.

Në datën 05.03.2025 u shpall ankandi i parë publik për shitjen e sendit të sekuestruar. Proçedura e ankandit të parë vazhdoi për 15 ditë dhe përfundoi me mbarimin e orarit zyrtar në datën 20.03.2025.

Nga proçedura e zhvillimit të ankandit të parë publik dhe nga proçesverbali i zhvillimit të tij, rezultoi se gjatë afatit 15-ditor të afishimit të shitjes së sendit të paluajtshëm ashtu si edhe në ditën e zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertues për blerjen e sendit të paluajtshëm.

Në datën 28.04.2025 u shpall ankandi i dytë publik për shitjen e sendit të sekuestruar. Proçedura e shpalljes së ankandit të dytë vazhdoi për 15 ditë dhe përfundoi me mbarimin e orarit zyrtar në datën 13.05.2025. Nga proçedura e zhvillimit të ankandit të dytë publik dhe nga proçesverbali i mbajtur i zhvillimit të tij, rezultoi se gjatë afatit 15-ditor të afishimit të shitjes së sendit të paluajtshëm ashtu si edhe në ditën e zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertues për blerjen e sendit të paluajtshëm.

Çdo veprim i kryer nga ana jonë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv i'u është komunikuar palëve te cilët kane marre dijeni zyrtarisht.

Për këto arsye:

Në bazë të neneve 568, 570 e 577 të Kodit të Procedurës Civile, të Ligjit nr. 08 datë 02.02.2023 "Për organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror" dhe udhëzimit nr. 05 datë 12.12.2012 "Për Përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbaruesi gjyqësor", unë Përmbaruese Gjyqësore Stela Gjergji

VENDOSA:

1. Shpalljen e shitjes në ankand të tretë publik, jo më të ulët se 10 përqind të çmimit të përcaktuar në ankandin e dytë për pasuritë si më poshtë:
 - a. Pasuria nr. 4/819+1-1 volum 25 fq 49 zk 8631 me sip 27.31m², ndodhur në Lagjen "Varosh", Lezhë, në veri të bulevardit "Gjergj Fishta" ngjitur me të, në lindje të rrugës së spitali, 30 m larg saj, përballë ish mapos 2-katëshe ne emer të debitorit Fran Gjon Bushpepa. Çmimi i shitjes së ankandit të tretë publik është në vlerën **2.721.600 (dy milion e shtatëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind)lekë**
 - b. Pasuria nr. 4/819+1-3 volum 25 fq 51 zk 8631 me sip 56.21m² ndodhur në Lagjen "Varosh", Lezhë në veri të bulevardit "Gjergj Fishta" ngjitur me të, në lindje të rrugës së spitali, 30 m larg saj, përballë ish mapos 2-katëshe ne emer të debitorit Fran Gjon Bushpepa. Çmimi i shitjes së ankandit të tretë publik është në vlerën **3.376.800(tre milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind)lekë**
 - c. Pasuria nr. 4/819+1-5 volum 25 fq 53 zk 8631 me sip 28.8m² ndodhur në Lagjen "Varosh", Lezhë në veri të bulevardit "Gjergj Fishta" ngjitur me të, në lindje të rrugës së spitali, 30 m larg saj, përballë ish mapos 2-katëshe ne emer të debitorit Fran Gjon Bushpepa. Çmimi i shitjes së ankandit të tretë publik është në vlerën **1.102.800 (një milion e njëqind e dy mijë e tetëqind)lekë**

Me këtë shpalljen njoftohen të gjithë të interesuarit se:

2. Vendi ku do të zhvillohet ankandi i tretë publik i shitjes së sendit është Zyra Vendore Përmbarimore Lezhë, e cila gjendet në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë
3. Ankandi i tretë publik për shitjen e sendit të paluajtrashëm shpallet sot me datën 20.06.2025 dhe do të qëndrojë i publikuar deri në datën 07.07.2025, ditë e Hënë, ora 16.00
4. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë/pasurive në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe /ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij /saj me prokurë, si dhe të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor deri në orën 16.00 këto dokumenta:
 - Kërkesën e tij/saj për pjesmarrje në ankand.,
 - Faturën bankare të 10% të garancisë për pjesmarrje në ankand (në original)
 - Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pashaportë)

Në rast se ofertuesi është person juridik, paraqet sipas rastit : Vërtetimin nga Qendra kombëtare e Regjistrimit; Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore ose NIPT-in.

5. Secili ofertues që merr pjesë në ankand nëpërmjet paraqitjes së ofertës, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci, pranë bankes Raiffeisen në numrin e llogarisë AL21202540050000001100003671 ose pranë bankës Credins në numrin e llogarisë IBAN AL12212110090000000000151555 të zyrës së përmbarimit Lezhë një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Kreditori nuk lë garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.
6. Nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand si ofertues debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor, si dhe personat e përcaktuar në nenin 709, të Kodit Civil, dhe që sipas nenit 572, të Kodit të Procedurës Civile.

7. Gazeta "Panorama" dhe "Dita" sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i KPrC këtë vendim detyrohen ta publikojnë 5 ditë me radhë në gazetatat e tyre. Për shërbimin e kryer pala kreditore merr përsipër pagimin e shumë e cila më pas sipas nenit 525 të KPrC do ti llogaritet palës debitoare.
8. Pala kreditore duhet të paraqesë tek përmbaruesi gjyqësor një kopje të faqeve të gazetave të cilat kane publikuar vendimin 5 ditë me radhë.
9. Ky vendim hartohet në 10 kopje. 1 kopje administrohet në dosjen përmbarimore. 1 kopje afishohet në ambientet e Zyrës Përmbarimore Lezhë. 1 kopje afishohet në vendin ku ndodhet pasuria e paluajtshme, 1 kopje i njoftohet debitorit, 1 kopje i njoftohet kreditorit, 2 kopje i njoftohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Bashkisë Lezhë për afishim në ambientet e tyre publike, 1 kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë si dhe 2 kopje iu njoftohen për publikim gazetave "Panorama" dhe "Dita".

PËRMBARUESE GJYQËSORE

STELA GJERGJI

